

Gjykata komunale për kundërvajtje në Ferizaj, sipas gjyqtarit Ragip Namani, me pjesëmarrjen e sek.juridike Imrane Shabani, në procedurën kundërvajtëse kundër Binaze Jasharit nga fshati Doganaj për shkak të veprës nga neni 16.1.1 të Ligjit për deklarimin e prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarve të lartë publik, dhe duke u bazuar në nenet 31,73 dhe 195 të Ligjit për kundërvajtjet me datë 25.06.2010 merr:

AKTVENDIM

E pandehura Binaze Habib Jashari e lindur më 21.09.1956 nga fshati Doganaj KK Ferizaj, prodekan për mesim në FSHTA –Ferizaj..

është përgjegjëse,

Sepse si zyrtare e lartë publike brenda afatit të lejuar ligjor përkatësisht deri me 31.03.2010 nuk ka deklaruar deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë te agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë.

-me çka ka kryer vepër nga neni 16.1.1. të Ligjit për deklarimin e prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarve të lartë publik..

-andaj në bazë të dispozitës së cekur ligjore.

DENOHET

ME GJOBË në shumë prej 300 €.

Dënimin e shqipëtuar duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi. Nëse të njëjtin nuk e paguan në afatin e caktuar, do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 20 ditësh.

Në emer të shpenzimeve procedurale obligohet që të paguaj shumën paushalle prej 5 €, në afatin e njëjtë sikur edhe dënimin në të holla.

Nga një ekzemplar i këtij aktvendimi u dërgohet palëve.

Arsyetimi

Agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë, kësaj Gjykate i parashitroi kërkesën nr.01/2318/10 të datës 08.06.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehures, për shkak të kundërvajtjeve të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjyqtari filloi procedurën kundërvajtëse mori në pyetje të pandehuren e cila në deklaraten e saj pranoi kundërvajtjen e cila i ngarkohet por në mbrojtjen e saj shtoi se nuk e ka ditur se i perket kategorisë së zyrtarve të lartë dhe se nuk e ka ditur se është dashur të bëjë deklarimin e pasurisë, më tutje në deklaraten e saj shton se formulari për deklarimin e pasurisë i është dërguar kah fundi i marsit ku ka pasur afat vetëm 2 ditë për deklarimin e pasurisë vjetore dhe pranon se në këtë afat nuk ka vepruar dhe nuk e ka dërguar aplikacionin për deklarimin e pasurisë.

Në bazë të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse deklarates së të pandehures si edhe shkresave tjera të lëndës gjyqtari vleron se e pandehura ka kryer kundërvajtje nga neni 16.1.1 të Ligjit për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarve të lartë publik, për çka u shpall përgjegjëse dhe u dënua si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjatë matjes së dënimit është marrë parasysh pesha e kundërvajtjes dhe pasojat e saj, rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, gjendja ekonomike e të pandehures andaj iu shqipëtua një dënim i këtillë me bindje se edhe me këtë lloj dënimi do të arrihet qëllimi ndëshkimor.

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së lartë për kundërvajtje në Prishtinë, brenda afatit prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj Gjykate pa pagesë takse.

Vendosur në Gjykatën komunale për kundërvajtje në Ferizaj, më 25.06.2010.

Sek. Juridike
Imrane Shabani

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGJENCIA PROTIV KORUPCIE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Br. Prot.
Dep.	Prot. No.
Nr. i faq.	Data

03/2514/10

